



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK
KRYETARI

Nr. 1792 Prot.,
3

Tiranë, më. 05 . 07 .2024

Lënda: Kthim përgjigje

Z. GENCI GJONÇAJ
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.4, Tiranë

Z. FATMIR XHAFAJ ✓
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.4, Tiranë

Të nderuar,

Në përgjigje të shkresës suaj me nr. 2654 prot., datë 01.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1792 prot., datë 03.07.2024, me objekt: "Kërkesë për bashkëpunim dhe angazhim", ku referuar rezolutës "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", dhe në zbatim të kësaj rezolute, Kuvendi i Shqipërisë, ka miratuar me vendimin nr. 50/2024, ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", po ju përcjellim bashkëlidhur dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, si vijon:

- Së pari, Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e kërkesës suaj, ka ngritur urdhrin nr. 416, me nr. 1792/1 prot., datë 04.07.2024, "Për krijimin e grupit të punës "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", me qëllim dhënien e kontributit në veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Më poshtë, ju bëjmë me dije, të dhënat e përfaqësuesve të Komisionit të Prokurimit Publik, të cilët do të japin kontributin e tyre në veprimtarinë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në procesin "Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian", si vijon:

Emër / Mbiemër: Alma Milo

Pozicioni i punës: Inspektore, pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Email: alma.milo@kpp.gov.al

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kati i Parë, Tiranë.

Emër / Mbiemër: Anxhela Fusha

Pozicioni i punës: Inspektore, pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Email: anxhela.fusha@kpp.gov.al

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kati i Parë, Tiranë.

Emër / Mbiemër: Aurela Gera

Pozicioni i punës: Inspektore, pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Email: aurela.gera@kpp.gov.al

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kati i Parë, Tiranë.

Emër / Mbiemër: Ergys Streza

Pozicioni i punës: Inspektor, pranë Komisionit të Prokurimit Publik

Email: ergys.streza@kpp.gov.al

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", "Pallati i Kongreseve", Kati i Parë, Tiranë.

- Lidhur me të dhënat që Komisioni i Prokurimit Publik (KPP), disponon mbi gjetje, vlerësime dhe plane veprimi për çështjet e korrupsionit dhe luftës kundër tij, ju informojmë se KPP, ka ngritur Urdhrin me nr. 96, datë 09.04.2021, "Për miratimin e procedurës antikorrupsion në Komisionin e Prokurimit Publik", me qëllim sinjalizimin, denoncimin dhe marrjen e masave mbi praktikat korruptive brenda institucionit. Bashkëlidhur do të gjeni, relacionin e Komisionit të Prokurimit Publik, me nr. 1792/2 prot., datë 04.07.2024, i cili shpjegon në mënyrë të detajuar veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, lidhur me çështjet e korrupsionit dhe luftën kundër tij, të realizuara në 5 vitet e fundit.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

Me respekt,

